



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KP.nr. 52/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen juridike të Paditësit “T... ” Sh.A., me seli në adresën Parku Industrial Mitrovicë, ndaj të paditurit “K...” L.L.C, me seli në Prishtinë, Rr. “.....me objekt kontesti lirimi i pronës, jashtë seance me datën 02.11.2022 merr këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet e tërhequr padia e paditësit “T... ” Sh.A., me seli në Mitrovicë, e ushtruar më datën 16.09.2008 kundër të paditurit “K...” L.L.C, me të cilën ka kërkuar lirimin e pronës.

A r s y e t i m

Paditësi më datën 16.09.2008 në Gjykatën Komunale në Prishtinë ka ushtruar padi, ndaj të paditurit paditurit “K...” L.L.C me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar lirimin e pronës.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të padisë ka vërejtur se paditësi gjatë deponimit të padisë në gjykatë nuk ka bërë pagesën e taksës gjyqësore prandaj gjykata përmes vërejtjes për pagimin e taksës gjyqësore të datës 19.09.2022 e ka ftuar paditësin që na afat prej 15 dite të paguaj taksën gjyqësore në shumë prej 20,00 € dh, duke e paralajmëruar edhe me pasojat ligjore në kuptim të nenit 253 të LPK-së.

Në shkresat e lëndës ekziston prova-fletë kthesa se paditësi me datë 22.09.2022 e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore të kësaj gjykate KP.nr.52/22 datës 19.09.2022 me të

cilin është ftuar për pagimin e taksës gjyqësore, duke u paralajmëruar për pasojat ligjore, ndërsa deri në ditën e marrjes së këtij Aktvendimi i njëjti nuk e ka paguar taksën Gjyqësore.

Duke marr parasysh faktin se as pas vërejtjes për pagim të taksës gjyqësore të dërguar nga gjykata, paditësi nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për padinë e parashtruar dhe nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga detyrimi i pagimit të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, duke u bazuar në nenin 253 par. 5 të Ligjit të Procedurës Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) ku është përcaktuar se *“në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”*

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti i Përgjithshëm

KP.nr.52/22, datë 02.11.2022

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.